

EVALDA PACI

**RRETH VISARIT LEKSIKOR NJË SHQIPËRIMI
TË DOM LEKË BITROJT (MARIJA, NANA E KSHILLIT T'MIRË,
SHKODËR, 1918)**

Botimi kushtuar Zojës së Këshillit t'Mirë dhe i përpiluar prej Dom Lekë Bitrojt i përket vitit 1918 e daton të jetë i afërt me realizime të tjera të ngjashme në pikëpamje destinacioni dhe përdorimesh gjuhësore, por jo plotësisht në pikëpamje të natyrës përmbajtësore. Marija, Nana e Kshillit t'Mirë (Shkodër, 1918), është një libërth që ka synime edukative religjioze, që evokon dhe elemente të jetës fetare e kulturore në qytetin e Shkodrës, por në themel paraqitet si shqipërim, siç dhe thuhet në faqen e parë të tij.

Vetë personaliteti i Dom Lekë Bitrojt është bërë i njohur ndër të tjera pikërisht nëpërmjet përpilimesh të tilla, që kanë parë dritën e shtypit në Shtypshkrojtjen e Zojës së Paperlyeme, Shkodër. Dom Lekë Bitroj paraqitet si përpilues i një doracaku vërtet modest në pikëpamje vëllimi, por mjaft të pasur në përdorime formash e fjalësh që ruajnë një lidhje të pamohueshme me një traditë shkrimore paraardhëse e që lidhet si me liturgjinë e përditshme, ashtu dhe me tekste të veçanta në pikëpamje ndërtimi dhe përfshirjeje në manuale më të gjera e më të plota.

Zoja e Këshillit të Mirë u bë pjesë e mjaft trajtesave, e në veçanti e gjurmimeve teologjike, e kësaj nuk mbeti vetëm objekt i gojëdhënave që rrëfejnë historinë e një fugureje që migron prej qytetit të Shkodrës për të gjetë një seli tjetër në Genacan, afër Rome. I gjithë misteri dhe ndjesitë që shoqërojnë brendësimin e kësaj figure te besimtarët e shumë ndihet qartë dhe në këtë libërth të shqipëruar nga Dom Lekë Bitroj¹.

Oficja vetë, që dhe në periudhën që i prin Koncilit të Trentit por dhe në atë që e pason atë, e ka atë në qendër të përmbajtjes, duke i kushtuar jo vetëm hapësira leximi të himneve më të njohura në praktikën përkatëse liturgjike, është një prej elementeve tekstologjike më të gjurmara dhe prej filologëve të teksteve të vjetra shqipe, në veçanti prej Eqrem Çabejt në shënimet me të cilat pajis dhe introdukton tekstet e librit të Gjon Buzukut.

¹ Nga ana tjetër, mbeten për t'u konsideruar si më poetiket himnet dhe format e tjera tekstore që i kushtohen kësaj figure aq të veçantë femërore e që është e pranishme në çdo praktikë liturgjike e konkretisht në librat e orëve, në breviarë e në liturgjinë e përditshme.

Duke pasur në vëmendje kryesisht figurën e Zojës së Shkodrës, por që në emërtimin në frontespis gjendet në siglën *Marija, Nana e Kshillit t'mirë*, krejt libërthi shihet se mbart tipare trajtesash apo tekstesh që lidhen si me këtë figurë femërore të rëndësishme, aq dhe me shfaqjet e saj në botën shqiptare e më saktë në atë të qytetit të Shkodrës.

Si ndikim i kësaj tradite, një figurë e tillë që në tekstet më të vjetra që disponojmë në gjuhën tonë ka një rol thelbësor dhe zë një vend të konsiderueshëm në disa pikëpamje. Tekste himnodike si *Falemi Rregjinesha, Falemi Mëri, Të n'falemi uilli i detit*, jo vetëm u vijuan të transmetoheshin e të ishin natyrshëm pjesë e liturgjisë së orëve në botën e krishterë katolike shqiptare, por dhe pasuruan ndjeshëm një arsenal tekstesh që dhe sot e kësaj dite shquhen për elemente të një literaliteti e shprehësie të rrallë poetike. Vijimësia në përdorim e këtyre varianteve dëshmoi gjithashtu se të tilla tekste u shqipëruan duke pasur vëmendjen e duhur nga ana e kujdesuesve të tyre, ndër të cilat radhitet edhe autori i *Mesharit*, por dhe ata që e pasojnë, përfshirë më të vonët që u mjaftuan në përshtatje katekizmash e tekstesh më të përmbledhura në pikëpamje të përmbajtjes.

Për t'iu kthyer këtij vëllimthi që e ka gjithashtu në qendër të vëmendjes figurën e Zojës së Shkodrës, vërehen në të nota të një rrëfimi që mbart qartë dhe dimensionin historik të dukurisë që lidhet me këtë të fundit. Autori i tij e sjell në mënyrë të thjeshtë në pikëpamje narracioni, por shihet qartë se ai njeh po aq mirë dhe interpretime që mëtojnë të zgjerojnë dimensionet e këtij fenomeni: adhurimin e Nunciatës në një kontekst shkodran si dhe bartjen e personazhit në një kontekst tjetër, më të largët gjeografikisht e me gjasë dhe në pikëpamje të tjera. Bëhet fjalë për vitin 1467 e ky fakt na shtyn gjithashtu t'u referohemi dhe burimeve të tjera, të shkruara në origjinal në gjuhën latine.

Sado që mund të konsiderohet një botim përmasash modeste në pikëpamje vëllimi, pikërisht për këtë arsye bie në sy centraliteti që zë figura e Marisë. Asaj i kushtohen krijime të tëra, të cilat ruajnë qartë lidhjen tematike dhe me tekstet e sipërpërmendura, duke qenë këto të fundit më afër praktikës së përditshme liturgjike. Ndjeshmëria me të cilën dhe vetë shqipëruesi dhe përshtatësi i saj e paraqet veprën, receptohet në çdo element të sajën, deri në detajet e fundit. Ndërthurja përmbajtësore e tekstologjike e këtyre krijimeve që sillen në faqet e fundit të libërthit pikërisht me himnet e mësipërme përbën një prej veçantive më të dukshme të këtij vëllimi sintetik.

Autori i ka kushtuar vëmendje dhe vetë historikut të rrugëtimit që motivi që ka të bëjë me Marinë e Këshillit të Mirë dhe me vendin që ajo zë në një botë shqiptare e më konkretisht në Shkodër dhe me një destinacion të mëtejshëm të saj, siç është Genacani. Tekstet bien në sy për përdorimet që duket se janë pjesë e formimit të meshtarit Dom Lekë Bitroj, por dhe për një koncizitet sa të natyrshëm, aq dhe dëshmi e qartë e faktit që shqipëruesi i tyre ishte në gjendje t'ia përshtaste ato natyrës sintetike të vetë veprës së paraqitur².

Të tilla botime që datojnë nga fillimi i shekullit të kaluar veçohen ndër të tjera dhe për arsye të përdorimeve që krejt natyrshëm evokojnë gjuhën e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe. Janë këto përdorime të rëndësishme dhe për arsye të regjistrimit leksikor të cilit i përkasin. Ndër to veçojmë për efekt ilustrimi disa trajta, kryesisht emërore dhe ndonjë foljore:

fugure, me kuptimin e imazhit ikonografik, por që është element i rëndësishëm i praktikës së liturgjisë së orëve në jetën e një të krishteri:

- Mos t'jeet konak nder vënde t'ona qi mos t'a keet *fuguren* e Zojës s'Kshillit t'Mirë; e aty para asajë fugure t'biim shpesh n'giujë me e lutë Zojen per ndimë.³

Shêjtnore, si referim ndaj objektit të kultit, një emër femëror që na kujton asnjansin latin *sanctuarium*:

- Shum perkushtimtarve t'Zojës s'Kshillit t'Mirë ndoshta kurr nuk kaa per t'ju raa rasa me shkue me e paa fuguren e mrekullueshme t'onen n'Gjenacan e m'u knaqë tuj u lutë n'at *shêjtnore*. E edhë me ju raa rasa nuk mundem me ndejë aty veç per pak kohë.⁴

- Edhë t'Nderueshmit Atnit Agostinian qi e kan n'dorë *shêjtnoren* e Gjenacanit me zeell t'palodhshem u orvatne pa ja daa me e qitë n'dritë n't'kater anët e botës ket divocjon si me shkrime si me t'hapun fuguresh e medajash.⁵

Mishriir, një fjalë fort e ndeshur dhe në tekstet e librit të Gjon Buzukut, së bashku me të tjera të përafërta në pikëpamje të përkatësisë në të njëjtën familje fjalësh:

² Emri i autorit H. Dach citohet në frontespis të këtij vëllimthi, krahas emrit të shqipëruetit Dom Lekë Bitroj.

³ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 83.

⁴ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 85.

⁵ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 78.

- Prandej ngule n'zemer t'ande sod premtimin mos m'u disprue kurr nder travajë, por me shpnesue *n'mishriir* t'pamarueme t'Zotit e n'mprojnii t'Nanës s'Tii Zojës s'Kshillit t'Mirë⁶.

- Tyy, o Nanë *mishrret*, po t'a fali ket zemer t'ngratë, ti dlire e pastroje e bane t'dejë per Jezu Krishtin Bitin t'and t'hyjnueshmin, qi me Atin e me Shpirtin Shëjt jeton e sundon per jetë t'jetës. Ashtû kjoftë⁷.

Pendesë, përdorur krahas emrash të tjerë si *lmoshë*, *uratë* etj.:

- Kush hiin n'ket shoqnii do t'a diin se kaa pjesë nder Meshë, Kungime e t'tana vepra tjera t'divoçme qi bahen paa prâa n'shëjtnore t'Gjenacanit, e se t'gjitha uratët, *lmoshët*, *pendesët* e veprat e mira tjerat qi n'kater anët e dheut bâhen prej sivllazenve a kumpanjorve t'Zojës s'Kshillit t'Mirë janë si me i pasë bâa aj vetë, persë kaa pjesë edhe aj n'meritime t'tynve.⁸

shuguroj, përdorur në më se një rast me kuptimin e kushtimit, por gjithsesi interesant se në këndvështrimin tonë përbën një shfaqje të re të kësaj fjale:

- Per dite *i shuguron* Zotit shum kohë *nder uratë*.⁹

- Ajo *i shuguron* jo vetun kohen e punen t'dashtunes Nanës s'vet, por edhe t'tanë pasuniin per me i ngrahë Zojës një kishë t'ree!¹⁰

Shuguroj, *shugurim*, *e shugurueme*, *i/e shugurueshme* ndeshen po në këtë botim në kontekste specifike që kanë të bëjnë me sakramendet e liturgjisë.¹¹ Një arsenal i tërë emërtesash do të citohej në lidhje me këtë: *hostje*, *sakrific*, *tabernakull*, *kelshëjt* etj.

Uratë, fjalë që dëshmohej që në tekstet e librit të Gjon Buzukut në trajtën *oratë* (kjo e fundit me foljen latine *oro*, *orare*) e mjaft e pranishme në gjuhën e liturgjisë në gegërishte. Një qasje interesante do të përbënte dhe krahasimi me përdorimet gjegjëse në botimin *Visari i Kongregacionit i Atë J.Junkut S.I.* (Shkodër, 1930):

⁶ Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar, Shkodër, 1918, f. 32.

⁷ Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar, Shkodër, 1918, f. 33.

⁸ Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar, Shkodër, 1918, f. 86-87. Vëmë re se përveç shumës *pendesët* që u citua në këtë shembull në këtë vëllimth mund të gjurmohet dhe trajta *Ndjesët*, gjithashtu në numrin shumë. Shih ndër të tjera te Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar, Shkodër, 1918, f. 87.

⁹ Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar, Shkodër, 1918, f. 48.

¹⁰ Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar, Shkodër, 1918, f. 49.

¹¹ Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar, Shkodër, 1918, f. 45: N'gjytet t'vogel t'Gjenacanit, pak lerg prej Romet, u gjindte qyshë motit një kishë e *shugurueme* t'Shëjtnueshmes Virgjin me titull "Nana e Kshillit t'Mirë".

- O Zot i gjithpushtueshem e i gjithmishrirshem ndigioje *uraten* t'ême e t'fshamet e mia. Per meritime t'Zojës s'bekueme e t'gjith shêjtnave po t'lutem me m'i falë mkatet e mia, ashtu qi me zêmer t'dliir t'mundem me e paa kket meshë e me xjerrë fryt. Ashtu kjoftë.¹²

Kreatyrë, një fjalë që e ndeshim dhe në veprat e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe, cituar gjithashtu si element i gjuhës kishtare në gjurmimet etimologjike të Eqrem Çabejt.¹³

- Ç'fryt i çmueshem per nee **kreatyrë** t'shkreta e nierz t'ligisht qi per kurrjaâ send kuqena e turpnohena prej sendeve t'ksajë tokë!¹⁴

Shekull, përdorur në kuptimin e botës tokësore me tundimet e saj:

- Per t'vertetë zâni i Zojës qi na thrret me jau vûe kamen mârrinave t'*ktii shekull* âsht mâa i amel se ç'do mjaltë! Kush praa e ndigion zânin e Zojës kaa me dalë fitues e nuk kaa m'u kuqë e m'u turpnue n'gjygjë t'mramë *para shekullit* marë.¹⁵

Pushtede: .. por premtimi i Zojës fjalë per fjalë kaa me dalë pse ajò e Lumja kaa *pushteden* me i çue n'vënd fjalët e veta.¹⁶

Vullndesë, siç dhe figuron në tekstin e mëposhtëm, por që do ta citonim pikërisht sepse ka mbijetuar dhe në leksionarët e sotëm dhe në lutjet themelore të liturgjisë së krishterë e në veçanti në atë të orëve:¹⁷

- M'xiir prej t'ând Biir, o Nanë e pushtueshme, qi une t'a njof *vullndesen* e tii e t'i ndigioj.¹⁸

¹² *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 99. Ndërkohë ndeshet dhe femërori lute për këtë fjalë, *po aty, botim i cituar*, f. 101: O Jezu Kinji i Zotit qi i shlyjnë mkatet e gjith nierzve ndigioje *luten* e gjamen t'onë per meritime t'shêjtnueshmes Nanës t'ande.

¹³ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes, K-M*, Botime Çabej, Tiranë, 2014, f. 135. P. Bogdani, *Cuneus prophetarum, botim kritik përgatitur nga A. Omari*, Tiranë, 2005, *Pjesa e dytë, Shkall. I, Ligj. II*, f. 6: Banë me dijtunë Gjoakini e Ana të parën e kishësë, se kishinë prum **kreatyrënë** për të mbushunë kushtimn e tyne e për ta lanë nd atë vend shêjt me të tjera virgjinesha, qi shërbyekeshinë nd atë kishë larg ngënjimeshit së shekullit, e aty plot me shêjtën të gjëllijnë e të punojnë gjithë sa duhej pr atë shêjte kishë, e me njinesë e me uratë e të tjera shêjte rangë të lëvdojnë Tenëzonë.

¹⁴ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 80.

¹⁵ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 80.

¹⁶ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 82.

¹⁷ Shih dhe *Shujta shpirtërore, libër uratësh përpiluar nga Dr. Gaspër Gjini*, Botime Drita, Ferizaj, 1987, f. 57: Ati ynë, që je në qiell, shejtnue kjoftë emni yt. Ardhtë mbretnia jote. U baftë vullnesa jote si në qiell ashtu në dhe.

¹⁸ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 33.

Trinii, si referim ndaj Trinisë shejte, në ndërtime si e *Shëjtnueshmja Trinii*, në një trajtë të përpunuar që njihet dhe sot e kësaj dite në gegërishte e nëse kemi parasysh rastet e citimit gjegjës në veprat e letërsisë së vjetër shqipe:

- O Virgjna e paperlyeme, Nana e Zotit, e Zoja e Kshillit t'Mirë! Bashkue me valle t'Froneve t'parrizit po e bekoj e e nderoj t'*Shejtnueshmen Trinii* per njat lumnii t'pashoqe me t'cillen ti jee baa pajtorja e jonë e nana e t'gjith nierzve.¹⁹

Do të veçonim gjithashtu dhe përdorime që dëshmojnë veçanti në pikëpamje të formimit të tyre: *qetii*, *lumnii*, *plotnii*, *pervujtnii*, *pastrii*, *madhnii*, *duresë*, *mprojnii*, *mjerii*, *shkretii*, *Hyjnii*²⁰, të gjitha me një konotacion që qëndron më së miri në një kontekst aq specifik për tematikën e kësaj vepërje.

Në këtë libërth mbizotëron emërtesa *Nanë*, *nana*²¹, por ndeshim dhe atributin *gurrë* në paragrafe si:²² ..per njat lumnii t'pashoqe me t'cillen ti je bâa **gurra** e t'tana hireve qi rrjedhin mii nee.²³ Ky atribut ndër të tjera radhitet ndër disa emërtime të tjera që i kushtohen posaçërisht kësaj figure të veçantë femërore: hylli i dedit (*botim i cituar, po aty*, f.35); tabernakulli i gjallë i Fjalës s' mishnueme (*po aty*, f.114), Bija e Atit t'Amshueshem, Nana e t'Birit t'Hyjnueshem, e Dashtuna qiellore e Shpirtit Shëjt (*po aty*, f.138); Mretnesha e qiellës e e dheut, Zoja e botës e Fituesja e ferrit (*po aty*, f.139); templi i Shpirtit Shëjt (*po aty*, f.140); bashkvepruesja e shëlbimit (*po aty*, f.140); Mretnesha e Martirve (*po aty*, f.141); pajtorja e jonë e nana e t'gjith nierzve (*po aty*, f.141); nana e mishriirs e streha e mkatnorve (*po aty*, f.142).

Ky botim që paraqitet si një doracak modest në pikëpamje vëllimi, përmban lavde e himne ndaj një figure femërore shumë të dashur në botën

¹⁹ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 141.

²⁰ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 109: Une besoj me gjith fuqii t'shpirtit t'ëm se n'ket hoste t'shugurueme është Korpi bashkë me Gjakun, me Shpirtin e me Hyjniin e Jezu Krishtit.

²¹ Për përdorimin e mbiemrit *amtare* shih në veçanti *Marija, nana e kshillit t'mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 79.

²² *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 110: O Zëmra e adhrueshme e Shelbusit t'ëm, *kroni* i dashtniis s'hyjnueshme, ndezun flakë per mue, ti pelqeje shpirtin t'ëm n'varrë të krahnorit t'and, ashtu qi n'ate shkollë dashtnijet t'xâa me i pergjegjë t'madhit Zot, qi m'dha kaq shum provë t'mrekullueshme t'dashtniis s'vet.

²³ *Marija, Nana e Kshillit t'Mirë, Botim i cituar*, Shkodër, 1918, f. 139.

shqiptare përveçse në praktikën e përditshme liturgjike. Një argument i tillë e një figurë si Zoja e Këshillit të Mirë ka përfshirë përherë prelatë, teologë e studiues të liturgjisë mariane.

Pavarësisht natyrës së veçantë të tekstit, në libër rimerren natyrshëm pjesë nga ungjijtë e nga Besëlidhja e Vjetër dhe si rrjedhim një terminologji e tërë që lidhet me një praktikë të rëndësishme në fushë të liturgjisë.

Do të përmendnim si trajta që në këtë vepër shihet se e kanë arritur një shkallë të caktuar konsolidimi, ashtu dhe përdorime që mbartin veçanti të mirëfillta në pikëpamje të kuptimit dhe konotacionit që marrin në përbërje të këtyre teksteve. Prania e disa orientizmave: baft (*Marija, Nana e Këshillit të Mirë, botim i cituar*, f.83),²⁴sahat (*po aty*, f. 89), adet (*po aty*, f. 106), ilakaa (*po aty*, f. 109), havaa (*po aty*, f. 13; f. 53), kurban²⁵, e bën sërish të krahasueshëm këtë vëllim me botime të tjera të ngjashme, qofshin dhe paraardhëse të tij.

Jemi të mendimit që nuk mund të jetë aspak e rastësishme prania e sa botimeve të tilla që ruajnë formatin e doracakut, por kanë një vlerë të madhe si për kohën kur panë dritën e shtypit, ashtu dhe për këdo që më tej në kohë vëzhgon me syrin e hulumtuesit përmbajtjen dhe brendinë e tyre. Nuk është e rastit as fakti që dëshmojmë jo në pak raste vijimësinë e përdorimit në këta libërtha të ndërtimeve nga veprat e letërsisë së vjetër shqipe. Ky botim i vitit 1918 është një tjetër dëshmi e kujdesimit jo të pakët ndaj gjuhës së liturgjisë dhe konsolidimit të regjistrit përkatës në gjuhën tonë.

²⁴ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II (A-B)*, Tiranë, 1976, f. 127-128.

²⁵ Të vihet re dhe përdorimi i fjalës *flîi* në një kontekst të caktuar të këtij vëllimthi, *Botim i cituar*, f. 48: Perkushtimi i sajë ndej Zojen e Këshillit të Mirë kaa sidomos trii sende t'dêja per kujtim: e 1-a Nji duresë e madhe: e 2-ta *nji flîi* e t'gjitha t'mirave qi kaa; e 3-a nji shpresë e pathyeshme.

